



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 58, datë 25.06.2024

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 5'829'106 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE



Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr.3806/1 prot, datë 29.03.2024 me kodin e produktit: "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"- kodi i produktit 91707AB dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 5'829'106 (pesë milion e tetëqind e njëzet e nëntëmijë e njëqind e gjashtë) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtme:


Nr.	Emër Mbiemër	Njësia Admin.	Data e kërkesës	Shkaku i fatkeqësisë sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012 dhe ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"	Preventivi për orendit/sendet llogaritur nga KQD	Preventivi për materiale ndërtimore llogaritur nga KQD, në masën 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012	Vlera e dëmit në total për përfituesit
1	Nasmije Mërkulaj	5	19.09.23	Zjarri	816,000	108,225	924,225
2	Fiqirete Kurti	Rrashbull	21.07.23	Zjarri	896,000	140,249	1,036,249
3	Enkeleida Rexha	2	16.01.24	Zjarri	771,000	Nuk ka dëme në zëra ndërtimor	771,000
4	Zeq Pashkaj	6	23.01.24	Zjarri	771,000	81,591	852,591
5	Shkëlqim Kapllani	Rrashbull	29.02.24	Zjarri	991,000	114,513	1,105,513
6	Zaim Aliaj	Rrashbull	16.04.24	Zjarri	490,000	649,528	1,139,528
Totali i vlerës për disbursim							5,829,106

- Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".
- Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 26.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 329/prot.
4

Durrës, më 01.07.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.58 datë 25.06.2024 ,” Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 5’829’106 lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

